

DEPARTAMENTI



I MBIKËQYRJES BANKARE

BANKA E SHQIPËRISË

Në ekonominë e një vendi veprojnë shumë ndërmjetës financiarë, midis të cilëve edhe bankat. Banka mundëson vënien në përdorim të fondeve të lira në mënyrë efikase pasi është institucion i specializuar për këtë lloj aktiviteti dhe disponon aftësitë e nevojshme. Kjo bën që bankat të kenë një rol të veçantë në ekonomi. Për shkak të këtij pozicioni kyç në ekonomi, përgjithësisht është pranuar që edhe në kushtet e një ekonomie tregu të lirë, bankat kanë nevojë të mbikëqyrën dhe të rregullohen. Misioni i mbikëqyrjes bankare është:

- të sigurojë stabilitetin e sistemit bankar dhe të mbrojë interesat e depozituesve dhe të publikut të gjerë;
- të sigurojë një sistem bankar të shëndoshë, aktiviteti i të cilit të jetë transparent dhe i udhëhequr drejt ekonomisë së tregut;
- të rrisë besimin e investuesve dhe të depozituesve nëpërmjet mbështetjes së zhvillimit të industrisë bankare dhe efektivitetit të saj.

Në mënyrë më të përqendruar funksioni i mbykëqyrjes bankare realizohet nga Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë, i cili është krijuar në gusht të vitit 1992.

Mbikëqyrje bankare realizohet nga Banka e Shqipërisë, si autoritet mbikëqyrës i sistemit bankar që në procesin e licencimit të bankave. Në përmjet rregullave dhe kërkesave të vendosura nga Banka e Shqipërisë ajo lejon hyrjen në tregun bankar vetëm të atyre subjekteve që premtajnë për një veprimtari të shëndoshë dhe të qëndrueshme.

Funksioni mbikëqyrës vazhdon me dy metoda plotësuese të njëra-tjetrës, që zbatohen njëkohësisht: mbikëqyrja e jashtme dhe inspektimi në vend.

Mbikëqyrja e jashtme lejon që të krijohet një ide mbi situatën e bankës bazuar në raportet financiare të saj. Që të mundësohet mbikëqyrja e jashtme, të gjitha bankat janë të detyruara të raportojnë të dhëna të sakta mbi situatën e tyre tek autoriteti. Kjo mori të dhënash analizohet. Me procesin e analizës kuptohet interpretimi i të dhënave për të evidentuar nëse banka është në gjendje të shëndoshë financiare dhe me çfarë problemesh ballafaqohet ajo.

Inspektimi në vend kryhet nga “skuadrat e inspektorëve”. Zakonisht, grupe inspektorësh vizitojnë bankën, inspektojnë aktivitetin e saj, evidentojnë problemet ose çështjet, që janë të nevojshme për t’u shqyrtuar ose për t’u patur në vëmendje, i diskutojnë me drejtuesit dhe në fund, për të gjitha këto çështje, përpilojnë një dokument që quhet “raporti i ekzaminimit” ku përfshihen edhe masat korrektuese dhe propozimet për rregullimin e situatës. Në varësi nga çështjet që inspektohen, inspektimet ndahen në inspektime të plota dhe të pjesshme. Inspektimi quhet i plotë kur inspektohet gjithë veprimtaria e bankës. Praktika është e tillë që për çdo bankë realizohet një inspektim i plotë një herë në 12 muaj. Inspektimi quhet i pjesshëm kur inspektohet një pjesë e aktivitetit të bankës, për shembull, vetëm aktiviteti huadhënës ose investues, ose veprimtaria valutore. Nevoja për kryerjen e inspektimeve të pjesshme lind nga nevoja për të mbikëqyrur më shpesh bankat, sidomos fushat që paraqesin rrezikshmëri të lartë.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe rregullimi bankar. Me “**rregullim bankar**” kuptohet procesi i hartimit dhe i nxjerrjes së rregullave dhe udhëzimeve të veçanta, të cilat kanë për qëllim të kufizojnë rrezikun që ndërmerr banka gjatë kryerjes së aktivitetit të saj. Kjo lidhet me faktin që bankat, në aktivitetin e tyre përdorin fondet e të tretëve. Këto rregulla dhe udhëzime lëshohen nën autoritetin e legjislativ. Këto rregulla përpunohen për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe në Shqipëri është vlerësuar që ato janë përgjithësisht në përputhje me këto standarde.

Arritjet më të rëndësishme të Departamentit të Mbikëqyrjes gjatë dhjetëvjeçarit të kaluar janë:

1. rilicencimi i bankave ekzistuese, me qëllim vënien mbi baza të njëjta të të gjitha bankave, me përjashtim të bankave, të cilat ishin licencuar në mbështetje të ligjit nr. 8075, datë 22.02.1996 "Për sistemin bankar në Republikën Banka e Shqipërisë";
2. unifikimi i tërësisë së tabelave dhe formularëve, që bankat raportojnë në Bankën e Shqipërisë çdo muaj;
3. zbatimi i planit unik kontabël;
4. hartimi i "Manualit të Ekzaminimit Bankar";
5. nënshkrimi i marrveshjeve të bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse të vendeve të tjera.

Synimet për të ardhmen

1. Përmirësimi dhe plotësimi i rregulloreve, duke mbajtur parasysh përafrimin, gjithmonë dhe më tepër, me standardet ndërkombëtare të mbikëqyrjes bankare, inkurajimin e konkurrencës së lirë, modernizimin e strukturës rregullative të mbikëqyrjes bankare.
2. Ndërtimi i "peer group" bazuar në disa karakteristika të bankave (në varësi kjo dhe të ecurisë e zhvillimit të sistemit bankar).
3. Rishikimi i treguesve të Sistemit të Paralajmërit të Hershëm.
4. Krijimi i një njësie shkencore në bashkëpunim me Departamentin e Kërkimeve dhe Politikave Monetare.
5. Qëndrueshmëria dhe kualifikimi i mëtejshëm i personelit.
6. Implementimi i teknologjive bashkëkohore të një tipi bazë të dhënash për ruajtjen, për përpunimin dhe për përdorimin e informacioneve të mbikëqyrjes bankare.